



**Shkolla Fillore Penn Alexander
Procesi i Regjistrimit të Kopshtit për vitin 2022 - 2023**

Më poshtë janë udhëzimet dhe afatet kohore që do të përcaktojnë se si do të kryhet procesi i aplikimit dhe përzgjedhjes për regjistrimin e nxënësve në klasat e kopshtit të shkollës fillore Penn Alexander (PAS) për vitin shkollor 2022-2023. **Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen përmes sistemit të regjistrimit online (OLR).**

Tabela Kohore e Procesit të Llotarisë për Kopshtin, Penn Alexander

| | |
|---|---|
| Datat e Regjistrimit | E Martë, 18 Janar, 2022 deri të Premten, 4 Shkurt, 2022 |
| Personeli i shkollës dërgon listën përfundimtare për OSEP përmes emailit. | E Premte, 11 shkurt 2022 |
| Drejtorja Arsimore përpunon aplikimet | 14 Shkurt 2022 – 18 Shkurt 2022 |
| Letra llotarie të dërguara në shtëpitë e nxënësve: | E Premte, 25 Shkurt 2022 |

Udhëzime të përgjithshme

- Vetëm fëmijët që banojnë brenda Zonës PAS/Penn Alexander School kanë të drejtë për llotarinë. Të gjitha aplikimet e marra pas mbylljes së periudhës së regjistrimit të Kopshtit do të vendosen në listë pritjeje dhe nuk do të merren parasysh në procesin e llotarise. Aplikacionet do të caktohen në listën e pritjes sipas radhës që ato merren duke filluar me numrin e parë pas llotarise të caktuar të studentëve. Aplikimet konsiderohen të plota pasi të jenë shënuar të plota nga sekretaria e shkollës.
- Dy dokumente që konfirmojnë vendbanimin brenda zonës kërkohen pas dorëzimit të materialeve të regjistrimit me një dokument pronësie, dokument qiraje e noterizuar, faturë e shërbimeve ose informacion të lëshuar nga qeveria. Faturat e ujit, “Residency affidavits dhe Delegations of Parental Responsibility “ NUK do të pranohen. I gjithë informacioni duke përfshirë imunitet DUHET të dorëzohet për shqyrtim. Informacion. Të gjitha aplikimet që plotësojnë kërkesat e vendbanimit do të vendosen në llotari.
- Ky njoftim do të rishikohet çdo vit dhe do vendoset në faqen e internetit të Drejtorisë Arsimore, kur drejtorja arsimore njofton regjistrimin e fëmijëve në kopësht në ose para ditës së Premte, 7 Janar. Të gjitha njoftimet do të përkthehen në tetë gjuhët kryesore të Drejtorisë
- Të gjithë formularët e regjistrimit duhet të dorëzohen në PAS brenda ose përpara afatit. Sistemi nuk do të pranojë më aplikime në orën 23:59 (pas orës 23:59 mesnatë) të së Premtes, 4 Shkurt 2022.
- Të gjitha vendimet e regjistrimit do të komunikohen vetëm me shkrim përmes emailit në adresën e emailit të përdorur në plotësimin e aplikacionit. Vendimet e regjistrimit nuk do të komunikohen me telefon dhe as letrat do t'u jepen prindërve nga Penn Alexander School ose Zyra e Regjistrimit dhe Vendosijs së Studentëve.
- Për më shumë informacion mbi procesin e regjistrimit online, ju lutemi vizitoni www.philasd.org/studentplacement/registration



Shkolla Fillore Penn Alexander
Procesi i Regjistrimit të Kopshtit për vitin 2022 - 2023

Vërtetimi i Adresës

Vërtetimi i Adresës (Duhet dy (2) dokumenta nga sa vijon)

Dokumentacioni i pranueshëm përfshin artikujt e renditur më poshtë: Një nga dokumentet duhet të jetë një akt, qira e noterizuar ose faturë e shërbimeve. Të gjitha informacionet e vendbanimit do të verifikohen për saktësi. Mund të kërkohet informacion shtesë gjatë procesit të verifikimit.

| | |
|---|---|
| Dokumenti i pronësisë | Karta e vlefshme e identifikimit DOT |
| Dokumenti i huas bankare për pronën“Mortgage” | Fatura aktuale e kredit kartës |
| Fatura aktuale e shërbimeve (gaz, elektrike) | Regjistrimi i fundit i automjetit |
| Fatura e fundit e tatimit të pronësisë (taksës) | Karta e regjistrimit të votuesit që tregon adresën aktuale |
| Patentë shoferi ose ndryshimi i kartës së adresës me adresën tuaj aktuale | Pasqyra e fundit bankare me adresen aktuale |
| Letra nga Zyra e Sigurimeve Shoqërore me adresën aktuale | Deklarata IRS ose deklarata të tjera të pagave dhe taksave, p.sh., W2, 1040, 1099 |
| Letra nga Zyra e Ndihmës Publike me adresën aktuale | Dokumenti i fundit i pagesës së punëdhënësit që tregon adresën aktuale |
| Foster care/kujdesi për fëmijët dhe letrat DHS janë të pranueshme për regjistrimin kur një student është nën kujdesin e një agjencie kujdestarie/përkujdesjeje për fëmijë | Dokumenti origjinal i qirasë me emrat e prindërve/kujdestarëve ligjorë dhe fëmijëve |
| Marrëveshja e nënshkruar e shitjes së pronës, e ndjekur nga kopje origjinale e dokumenteve të shlyerjes brenda 45 ditëve kalendarike nga data e vendimit | |